

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenet 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AK-KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 320-26-1332-2-1-1

Sa i përket tenderit për Auditimi i pasqyrave financiare të subjekteve politike

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"AlbAudit" SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Fehmi Lladrovci
(Adresa)
Ferizaj 70000
(Vendi) (Kodi postar)
044/121655 ///
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Remzi Jashari,
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
albaudit@hotmail.com
(Adresa elektronike)

29.06.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vullti)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka filluar me rastin e Njoftimit për Kontratë i publikuar në e-prokurimi me date 18.03.2026

Hapja publike parashihet të behet me dt 29.04.2026 ora 14:00

Kriteri i vlerësimit ka qenë Tenderii përgjegjshëm me çmimi **më të ulët**

Njoftimi mbi vendimin e AK duke Anuluar aktivitetin e prokurimit i dt. 12.06.2026

Kërkesa për Rishqyrtim më dt. 17.06.2026

Vendimi i AK duke Refuzuar kërkesen për rishqyrtim i dt. 19.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pakënaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues për rezultatin e aktivitetit të prokurimit, të publikuar në platformën e-prokurimit (B58), dhe në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), parashtrojmë këtë ankesë kundër:

1. Njoftimit për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit

Lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: Auditimi i pasqyrave financiare të subjekteve politike Nr. Prokurimi: 320-26-1332-2-1-1 të publikuar në ueb-faqen e KRPP-së më datë 12.06.2026 nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Autoritetit Kontraktues.

Pretendimet e Ankuesit:

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues, fillimisht përmes Komisionit për Vlerësimin, Ekzaminimin dhe Krahasimin e Tenderëve, gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, i cili ka rekomanduar anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, dhe më pas përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit (ZPP), me aprovimin e këtij rekomandimi ka bërë shkelje të dispozitave ligjore në vijim:

I. Shkeljet e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (në tekstin e mëtejshëm: LPP), konkretisht:

- **Neni 1 – Qëllimi;**
- **Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;**
- **Nenin 7 Barazia/ mosdiskriminim**
- **Neni 59 – Vlerësimi, Ekzaminimi dhe Krahasimi i Tenderëve;**
- **Nenin 52 paragrafi 7 I LPP-se**
- **Neni 62 – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit.**

II. Shkeljet e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Konkretisht:

- **Neni 43 – Ndërprerja e Aktivitetit të Prokurimit.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në vazhdim po ju njohim me faktet dhe argumentet që e mbështesin pretendimet tona lidhur për shkeljet e dispozitave të LPP-së nga ana e AK-së.

Pretendimet ankimore;

Shkelja e Nenit 1 të LPP-së – Qëllimi

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues, me vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Sipas paragrafit 2 të nenit 1 të LPP-së, Komisioni për Vlerësimin, Ekzaminimin dhe Krahasimin e Tenderëve, si dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, janë të obliguar që gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të sigurojnë respektimin e qëllimit të ligjit, duke garantuar integritet, transparencë, trajtim të barabartë dhe vendimmarrje të bazuar në fakte dhe në dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 1 i LPP-së përcakton se:

- Qëllimi i ligjit është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike;
- Të garantojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publikë të përfshirë në aktivitetet e prokurimit;
- Të nxisë një kulturë institucionale profesionale, të paanshme dhe etike, të bazuar në parimin e shfrytëzimit sa më efikas, ekonomik, transparent dhe të drejtë të fondeve publike.

Nga arsyetimi i dhënë në Vendimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur të dëshmojë ekzistimin e një qasjeje profesionale, të paanshme dhe të mbështetur në interesin publik. Përkundrazi, vendimi i kontestuar nuk demonstroi se janë respektuar parimet themelore të ekonomicitetit, efikasitetit, transparencës dhe konkurrencës efektive.

Për pasojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e nenit 1 të LPP-së, duke cenuar parimet bazë mbi të cilat ndërtohet sistemi i prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

Shkelja e Nenit 6 të LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues, me vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se “nuk ka pasur asnjë tender të përgjegjshëm”, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 të LPP-së.

Neni 6 i LPP-së përcakton se:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara të sigurojnë që fondet dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet dhe burimet publike të vëna në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm për qëllimet e kontratës përkatëse.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka anuluar aktivitetin e prokurimit pa ofruar arsyetim të mjaftueshëm dhe bindës që do të demonstroi se anulimi i procedurës përmbush kërkesat ligjore të ekonomicitetit dhe efikasitetit. Përkundrazi, anulimi i aktivitetit sjell vonesa në realizimin e nevojave të autoritetit kontraktues, krijon kosto shtesë administrative dhe cenon përdorimin racional të fondeve publike.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se me nxjerrjen e vendimit për anulim janë shkelur dispozitat e nenit 6, paragrafët 1 dhe 2 të LPP-së, pasi nuk është dëshmuar se vendimi i marrë i shërben përdorimit më ekonomik dhe më efikas të fondeve dhe burimeve publike.

Shkelja e Nenit 7 të LPP-së – Barazia/ mosdiskriminimi

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), pasi gjatë procesit të vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka zbatuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit në mënyrë të njëjtë, të drejtë dhe jo-diskriminuese.

Në mbështetje të këtij pretendimi, theksojmë se Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar më herët aktivitetin e prokurimit me titull “Auditimi i deklarimit financiar të fushatës për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 09.02.2025 – ritenderim”, me numër të prokurimit 320-25-4539-2-1-1, ku kërkesat e Dosjes së Tenderit kanë qenë të njëjta me ato të aktivitetit të prokurimit të zhvilluar në vitin 2026.

Po ashtu, gjendja faktike lidhur me licencat e auditorëve ka qenë e njëjtë edhe gjatë vitit 2025, për shkak se organi kompetent për lëshimin dhe ripërtëritjen e licencave, përkatësisht KKRF, nuk ka qenë funksional. Megjithatë, kjo rrethanë nuk është konsideruar si pengesë ligjore për vlerësimin e ofertës sonë si të përgjegjshme. Përkundrazi, në atë procedurë ne jemi rekomanduar për dhënie të kontratës nga i njëjti Autoritet Kontraktues dhe kontrata është realizuar me sukses dhe në tërësi.

Për këtë arsye, konsiderojmë se është e pashpjegueshme dhe në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë fakti që i njëjti Autoritet Kontraktues, për të njëjtin lloj aktiviteti, me kriteret identike dhe me të njëjtën situatë faktike lidhur me funksionalizimin e KKRF-së, në vitin 2025 e ka konsideruar ofertën tonë të përgjegjshme dhe na ka shpallur fitues, ndërsa në vitin 2026 e refuzon ofertën tonë me arsyetimin se licencat e auditorëve të lëshuara nga KKRF kanë skaduar në vitin 2024.

Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndryshime relevante në legjislacionin e prokurimit publik që do të justifikonin një qasje të ndryshme në vlerësimin e ofertës sonë. Për rrjedhojë, ndryshimi i qëndrimit të Autoritetit Kontraktues nuk mbështetet në bazë ligjore dhe paraqet trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë në rrethana të njëjta faktike dhe juridike.

Për më tepër, anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë pavarësisht faktit se oferta jonë është plotësisht e përgjegjshme dhe i plotëson të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit. Si rezultat, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të LPP-së, si dhe me dispozitat e neneve 56, 59 dhe 62 të LPP-së, duke cenuar parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, transparencës dhe konkurrencës së drejtë në procedurat e prokurimit publik. Për rrjedhojë, konsiderojmë se me nxjerrjen e vendimit për anulim janë shkelur dispozitat e nenit 7, pasi është dëshmuar se AK nje vit me heret me te njejtat kriteret dhe situatet e njejtë na ka rekomanduar per kontrate kurse tani e anulon aktivitetin e prokurimit.

Lidhur me shkeljen e Nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) vlerësimi dhe krahasimi i ofertave, dhe shkelja e nenit 52 paragrafi 7 i LPP-se, Njoftimi i kriterëve për dhënie të kontratës

Pretendojmë se Komisioni për Vlerësimin, Ekzaminimin dhe Krahasimin e Tenderëve, me rekomandimin dhe vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se “nuk

ka oferta të përgjegjshme”, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Neni 59 i LPP-së përcakton qartë mënyrën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, si dhe obligimin e autoritetit kontraktues që një ofertë të konsiderohet e papërgjegjshme vetëm kur nuk i plotëson kërkesat materiale të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Në veçanti, paragrafi 4 i Nenit 59 parasheh se autoriteti kontraktues mund ta konsiderojë një ofertë të përgjegjshme edhe kur ajo përmban gabime ose paqartësi që mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtet materiale të ofertës, apo devijime të vogla që nuk ndikojnë në karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Nga arsyetimi i dhënë në Vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk rezulton se oferta e operatorit ekonomik ALBAUDIT ka pasur mungesa materiale apo mospërputhje thelbësore me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Përkundrazi, operatori ekonomik ka dorëzuar të gjitha dëshmitë dhe dokumentet e kërkuara në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, nëse autoriteti kontraktues ka pasur paqartësi lidhur me ndonjë dokument apo informacion të paraqitur në ofertë, në bazë të paragrafit 2 të Nenit 59 të LPP-së ka pasur të drejtë të kërkojë sqarime me shkrim nga operatori ekonomik. Rrjedhë e kësaj, AK ka parashtruar kërkesën për sqarim lidhur më ri-licensimin e auditoreve, ku OE ka ofruar përgjigje duke qartësuar gjendjen e krijuar në mungesë të funksionalizimi të KKRF-së dhe njoftimin nga Divizioni përkatës i KKRF-së.

Bazuar në të dhënat e evidencuara në KKRF, më qëllim konfirmoni dhe plotësoni e informacionet lidhur me datat e ri-licensimit të licencave tuaja aktive, pa cenuar përmbajtjen materiale të ofertës. Moskonfirmimi i informacionit dhe anulimi i procedurës pa një vlerësim të drejtë dhe të plotë të ofertës bie ndesh me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Prandaj, konsiderojmë se vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është marrë pa bazë të mjaftueshme ligjore dhe në kundërshtim me dispozitat e Nenit 59 të LPP-së, pasi oferta e operatorit ekonomik ALBAUDIT ka qenë e përgjegjshme dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktues.

Lidhur me shkeljen e Nenit 52 paragrafi 7 të LPP-së

Se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 52 paragrafi 7 të Ligjit për Prokurimin Publik vërtetohet nga fakti se nuk ka bërë një kontroll efektiv të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, përkatësisht të licencave të lëshuara nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar e Fushës përkatëse (KKRF), ndonëse një verifikim i tillë lejohet dhe kërkohet nga dispozita e lartcekur.

Në rastin konkret, operatori ekonomik ka dorëzuar licencat e kërkuara sipas Dosjes së Tenderit dhe njëkohësisht ka paraqitur kërkesat për vazhdimin/ripërtëritjen e tyre brenda afateve ligjore. Megjithatë, për shkak të mosfunksionalizimit të KKRF-së, respektivisht mungesës së bordit kompetent për shqyrtimin dhe vendimmarrjen lidhur me kërkesat e operatorëve ekonomikë, nuk ka qenë e mundur që të merret një vendim formal mbi këto kërkesa.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim që, në përputhje me Nenin 52 paragrafi 7 të LPP-së, të kryejë verifikim efektiv pranë organit kompetent dhe të konstatojë gjendjen faktike lidhur me vlefshmërinë e licencave, para se të arrinte në përfundimin se operatori ekonomik nuk i plotëson kriteret e kualifikimit.

Për më tepër, Sipas **Nenit 100 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative**, nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ dhe organi publik nuk e njofton palën për vendimin brenda afatit ligjor, as për zgjatjen e afatit, kërkesa konsiderohet e pranuar dhe akti administrativ konsiderohet i **“miratuar në heshtje”**. Tutj në përputhje **nenin 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Organi Publik ka detyrim të vërtetojë të gjitha faktet relevante për para marrjes së vendimeve**. Lidhur më këtë sipas vendimit për anulim, AK ka kërkuar sqarime nga KKRF por nuk ka marrë përgjigje.

Rrjedhimisht, mosdhënia e përgjigjes nga KKRF-ja nuk mund të interpretohet në dëm të operatorit ekonomik, i cili ka vepruar në përputhje me detyrimet e tij ligjore dhe ka dorëzuar kërkesat përkatëse brenda afatit. Për më shumë, sipas nenit 30, paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, KKRF ka licencuar shoqërinë “AlbAudit” SH.P.K. si firmë ligjore vendore të auditimit dhe gjithë Auditorët sipas ”LISTA E AUDITOREVE LIGJOR” bashkangjitur në oferten e tenderit. Këto certifikata mbesin valide deri sa nuk është aktivizuar neni 31 i ligjit të sipërpërmendur, për faktin se Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, nuk ka përcaktuar afatin kohor të validitetit të licencave. Si rrjedhojë e kësaj (deri sa KKRF nuk ka leshuar një vendim specifik për revidimin apo pezullimin e ndonjë certifikate) të gjitha Firmat Ligjore të Auditimit dhe / ose Auditorët Ligjor kanë ofruar dhe vazhdojnë të ofrojnë shërbimet e auditimit.

Gjithashtu, vlen të theksohet se në një aktivitet të mëparshëm të prokurimit të zhvilluar nga i njëjti Autoritet Kontraktues gjatë vitit 2025, operatori ekonomik është rekomanduar për kontratë duke paraqitur të njëjtat licenca, të cilat kishin afat vlefshmërie deri në shkurt 2025. Në atë rast, Autoriteti Kontraktues ka pranuar se operatori ekonomik i përmbushte kërkesat e kualifikimit, pasi ishte lehtësisht e verifikueshme se kërkesat për vazhdimin e licencave ishin paraqitur me kohë pranë organit kompetent. Në këtë kuptohet se AK ka qenë në dijeni, para publikimit të njoftimit për kontratë dhe dokumenteve të tenderit, për situatën e krijuar rrjedhojë e mosfunksionalizimit të KKRF-së dhe vështërsitë objective që lindin lidhur më vendimet për ri-përrirjen e licencave të Auditorëve.

Për rrjedhojë, arsyetimi i Komisionit të Vlerësimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk mbështetet në gjendjen reale faktike, bie ndesh me dispozitat e Nenit 52 paragrafi 7 të LPP-së, me kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, si dhe me praktikën e mëparshme të vet Autoritetit Kontraktues në raste të njëjta.

Në mbështetje të këtij pretendimi, bashkëngjisim korrespondencën e zhvilluar me KKRF-në, e cila dëshmon se kërkesat për vazhdimin e licencave janë paraqitur në afat dhe se mungesa e një vendimi nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë lëshimi të operatorit ekonomik.

Prandaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të bëjë verifikimin efektiv të licencave të paraqitura, në përputhje me Nenin 52 paragrafi 7 të LPP-së, të rishqyrtojë vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe, pas rivlerësimit të drejtë dhe të plotë të ofertës, të rekomandojë për kontratë operatorin ekonomik ALBAUDIT SHPK i cili i përmbush në tërësi kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë.

Lidhur me shkeljen e Nenit 62 të LPP-së dhe Nenit 43 të Rregullores Nr. 01/2024

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues, me vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ka vepruar në kundërshtim me Nenin 62 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe me Nenin 43 të Rregullores Nr. 01/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Neni 62 i LPP-së përcakton në mënyrë taksative rastet kur një aktivitet i prokurimit mund ose duhet të përfundojë pa dhënie kontrate. Po ashtu, Neni 43 i Rregullores përcakton qartë kushtet në të cilat procedura e prokurimit mund të anulohet pas hapjes së ofertave.

Nga arsyetimi i dhënë në Njoftimin mbi Vendimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit nuk rezulton ekzistimi i asnjërës prej rrethanave të parapara në Nenin 62 të LPP-së apo Nenin 43 të Rregullores, të cilat do të arsyetonin anulimin e procedurës.

Autoriteti Kontraktues e ka bazuar anulimin në pretendimin se nuk ka pasur oferta të përgjegjshme. Megjithatë, ky konstatim nuk qëndron, pasi operatori ekonomik ALBAUDIT SHPK ka dorëzuar ofertë e cila i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për Kontratë, siç është argumentuar në detaje në këtë Kërkese për Ri-shqyrtim.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka zhvilluar verifikim efektiv të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, ndonëse një veprim i tillë lejohet dhe kërkohet nga Neni 52 paragrafi 7 i LPP-së. Si pasojë, përfundimi se oferta jonë është e papërgjegjshme nuk mbështetet në një vlerësim të plotë dhe objektiv të fakteve.

Në rastin konkret nuk ekziston:

- asnjë shkelje e ligjit që nuk mund të korrigojë apo parandalohet sipas Nenit 62 paragrafi 1.1 të LPP-së;
- asnjë rrethanë objektive dhe e paparashikueshme që do të justifikonte ndërprerjen e procedurës;
- asnjë tejkalim i buxhetit të autoritetit kontraktues nga ofertat e përgjegjshme;
- asnjë nga kushtet e tjera të parapara në Nenin 43.5 të Rregullores për anulimin e procedurës pas hapjes së ofertave.

Përkundrazi, anulimi është mbështetur në një vlerësim të gabuar të dokumentacionit të operatorit ekonomik dhe në mosverifikimin e rrethanave faktike lidhur me vlefshmërinë e licencave të paraqitura.

Gjithashtu, vetë praktika e mëparshme e Autoritetit Kontraktues dëshmon se në procedura të ngjashme dhe për të njëjtin aktivitet të prokurimit, operatori ekonomik është konsideruar i përgjegjshëm dhe është rekomanduar për kontratë mbi bazën e të njëjtit status juridik dhe dokumentacion të licencave, gjë që e bën vendimin e kontestuar jo konsistent dhe në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është nxjerrë në kundërshtim me Nenin 62 të LPP-së dhe Nenin 43 të Rregullores Nr. 01/2024, për shkak se nuk ekziston asnjë bazë ligjore që do të justifikonte anulimin e procedurës së prokurimit.

Përfundim

Si përfundim, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të vlerësoj në perputhje me kriteret e parapara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, të eliminojë paqartësitë përmes shfrytëzimit të nenit 52 paragrafi 7 i LPP-së duke eliminuar rrethana diskriminuese, si dhe të shmangë shkeljen e dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik.

Në të kundërtën, dhe pa dëshirën tonë, do të jemi të obliguar t'i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për mbrojtjen e të drejtave tona ligjore.

Andaj, bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të ndër marrë masat e nevojshme dhe të vendosë si vijon:

VENDIM

- **Të aprovohet:** kërkesa për rishqyrtim në tërësi si e bazuar, ndaj Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull Auditimi i pasqyrave financiare të subjekteve politike Nr. Prokurimi: 320-26-1332-2-1-
- **Të anulohet:** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues I publikuar me dt 12.06.2026 për anulimin e aktivitetit të prokurimit, me titull Auditimi i pasqyrave financiare të subjekteve politike Nr. Prokurimi: 320-26-1332-2-1-1 dhe lënda **të kthehet në RIVLERËSIM**, dhe vlerësimi i ofertave të bëhet në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit, Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 01/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. **Pas rivlerësimit të ofertave të rekomandohet për kontratë oferta e ALBAUDIT SHPK** pasi që e njëjta i plotëson të gjitha kriteret e parapara në njoftim për kontratë dhe doje të tenderit dhe njëkohësisht është oferta me çmimin më të lirë.

Në përmbyllje, shprehim besimin se kjo kërkesë do të trajtohet me seriozitet dhe në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe barazisë në trajtim të operatorëve ekonomikë, duke shmangur nevojën për përdorimin e mjeteve juridike sipas Nenit 109 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mos shpërblimi i ofertuesit, sjellë disa dëmi materiale për OE, si në vijim;

- *Dëmi material i shkaktuar nga anulimi i kësaj procedure të prokurimit vlerësohet në shumën prej 1,000.00 € (një mijë euro), i cili përfaqëson shpenzimet dhe kostot e përgatitjes së ofertës, dokumentacionit dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit. Ky dëm është shkaktuar si pasojë e anulimit të paarsyetuar dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik dhe akteve nënligjore në fuqi.*
- *Humbja e mundësisë për të fituar kontratën, OE, kishte planifikuar të fitonte kontratën, dhe nuk arrinë të shpërblehet, OE e humb mundësinë tejet të rëndësishme për të siguruar/fituar një kontratë të re.*
- *Ndikimi në reputacionin e OE. Mos shpërblimi i tenderit dhe mos shpërblimi i ofertes, ndikon negativisht në reputacionin. Përkatësisht ky veprim i AK, mund të shkaktojë dyshime mbi cilësinë e shërbimeve dhe produkteve të sajë.*

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin mbi vendimin e AK-se”*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve,*
- e) Korrespondencat me KKRF*
- f) Një kopje të njoftimit mbi Vendimin e AK-se të rekomanduar nga AK me 24.06.2025 për aktivitetin e prokurimit të njëjtë për periudhën e vitit 2025, nga i njëjti ZPP me kritere të njëjta.*
- g) Vendimi i AK për kërkesën për rishqyrtim*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*